**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës**

Datë 5.10.2026

# RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT, PËR PASURI PRIVATE TË PREKURA NGA INVESTIMI ME OBJEKT: "PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË VARREZAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE RRASHBULL".**

**Baza ligjore:**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pronave Publike, Menaxhimit të Aseteve dhe Procedurave të Shpronësimit, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për 8 (tetë) pasuri pronë private të prekura nga investimi "Përmirësimin e infrastrukturës së varrezave të Njësisë Administrative Rrashbull", në shumën totale prej 1423434.766 (një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë e katër, pikë shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, sipas vlerësimit të kryer nga Sektori i Pronave Publike, Menaxhimit të Aseteve dhe Procedurave të Shpronësimit.

2. Pasuritë që janë pa informacion sipas kartelave të pronësisë, të ardhura nga ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, në numër 2 (dy), të cilat janë përfshirë në projektin e investimit, do të përdoren nga Bashkia Durrës për realizimin e qëllimit publik të parashikuar, sipas përcaktimeve ligjore për administrimin dhe përdorimin e pronës shtet.

3. Subjektet përfituese nga shpronësimi, si dhe të dhënat e pasurive përkatëse, janë të detajuara në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsiderohen pjesë përbërëse e tij.

4. Fondi për shpronësimin do të përballohet nga buxheti i bashkisë për vitin 2027. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.

5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave për pagesën e shpronësimit ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Ligjore dhe Njësia Administrative Rrashbull.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Buxheti i bashkisë 2027.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Sektori i Pronave Publike, Menaxhimit të Aseteve dhe Procedurave të Shpronësimit

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët e Bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, u mblodhë më datë 5.10.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 1 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Komisioni i zhvillimit Urban u mblodh për të diskutuar për pikën 1. Pas diskutimeve ne si komision jemi dakort që të kalojmë këtë pikë.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit

d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

e- _____

**Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës**

| | |
|---|---|
| Kryetar | Jonada Mamo |
| Zv/Kryetar | Ardian Muka |
| Sekretar | Franc Tragaj |
| Anëtar | Munir Konesha |
| Anëtar | Denis Lika |
| Anëtar | Sami Osmani |
| Anëtar | Renald Koka |
| Anëtar | Anisa Ibraj |
| Anëtar | Kastriot Xhongoli |